



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRIN	
01 Nr. / Br	170/18
Nr. i fq. / Br. st	- 13 -
Data / Datum	28. 06. 2018
VUSHTRRI - VUÇITRIN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -V- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRIË, MBAJTUR MË 31 MAJ 2018

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:
Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërzhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Lutfi Bilalli, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, , Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Sami Istrefi.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës - z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës – z.Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit –kërkoj që peticioni i nënshkruar nga 700 qytetar për dhënien e titullit nderi i qytetit për Naser Imerin të futet në kuadër të pikës së 12 të rendit të ditës. Tutje duke ju referuar fillimit të punimeve për rrënimin dhe rindërtimin e objektit të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina ” shtoi se është e vërtet që vendimi për rrënimin e pjeshëm të këtij vendimi është marrë në kohën sa PDK ka qeverisur me komunën dhe ai vendim është marr me pajtueshmëri të të gjithëve. Pastaj vlerësoi se pasi u bë rrënimin i atij objekti u pa që vendimi ka qenë i drejt pasi që ai objekt nuk kishte qëndrueshmëri dhe çdo intervenim tjetër do të shkaktonte dëme të mëdha. Mandej duke ju referuar premtimit të kryetarit të komunës ceku se ai nuk u kishte përmbajtur zotimeve të tij dhe kjo nënkupton që ai është i gatshëm edhe për vendim tjera që mund të shkojnë edhe më larg. Në kontekst të projektit të sipërcekur shtoi se për parandalimin e këtij projekti ka pasur alternativa, pasi që një vendim i tillë ka mundur të shfuqizohet në kuvend pasi qeveria aktuale i ka pasur 23 vota në kuvend por këtë do ta mbështeste edhe grupi kuvendar i PDK-së, dhe në këtë rast do të mund të negociohet dhe rishqyrtohej edhe kontrata me operatorin ekonomik por siç po shihet kjo kontratë ka mbetur në sirtar për gjashtë muaj rresht dhe në këtë rast kryetari i komunës ka pasur takimi tjera sigurisht jo të interesit të përgjithshëm por takime të grupeve të caktuara dhe për këtë nuk e di se a ja ka arritur qëllimit por se kjo mbetet të shihet në të ardhmen. Në vazhdimi ai pyeti kryetarin se çka po e pengon familja Istrefi a mos ndoshta e kaluara e tyre

apo mos guximi për ballafaqim në të ardhmen. Andaj ai përkujtoj se qeverinë aktuale komunale qytetari e ka votuar si alternativ tjetër dhe jo që kjo qeveri të shtirret si viktimë e vendimeve të qeveris se kaluar. Në fund tha se është mire që qytetarëve të iu shpjegohet e kjo qeveri në tri vitet e ardhshme do të punoj me projektet e PDK-së, ndoshta kjo dikujt i shkakton dhimbje por kjo është e vërtetë, krejt kjo argumentohet me përrurimin e shkollës në Dumnicë, në Druar dhe Pantinë si dhe promovimi i zhvillimit të projektit për ndërtimin e kolektorit të ujërave të zeza që të gjitha këto projekte të PDK-së.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës –tha se në një veprim të pa precedent të transparencës në dymbëdhjetë vitet e fundit në komunë, si kryetar i komunës ka publikuar çdo dokument lidhur me projektin e qendrës së kulturës në faqen zyrtare të komunës, ku mund të ketë qasje çdo kush që dëshiron të ketë informata lidhur me këtë projekt. Tutje ai dha një kronologji të zhvillimeve lidhur me projektin qendra e kulturës duke shtuar se fillimisht nga eksponent të PDK-së në Vushtrri ishin bërë plane që në lokacionet e kësaj qendre të ndërtohen banesa kolektive, por se ky projekt ishte parandaluar nga reagimi qytetar dhe ai i LDK-së në radhë të parë. Këtë projekt për banesa kolektive e kishte hartuar një profesor universitar, dhe me qëllim të kësaj që të ndërtohen këto banesa, pushteti i PDK-së për vite të tëra nuk kishte investuar asnjë cent në këtë objekt me qëllim që ai të dëmtohet ashtu që të bëhet jo funksional dhe më vonë ai të rrënohet dhe të ndërtohen banesa kolektive dhe këtë gjë e dinë të gjithë qytetarët e Vushtrrisë. Në këtë kontekst ai vlerësoi se është e vërtetë që ai kishte premtuar në fushatë që ky objekt nuk duhet të rrënohet për shkak se konsideron se ky objekt ka vlera të trashëgimisë kulturore. Me datën 30 mars 2017 është marr vendimi për rrënimin e pjesëshëm të këtij objekti, kurse me 2 nëntor 2017 në kohë të fushatës para elektorale ishte shpall tenderi për kontraktimin e këtij projekti kurse me 15 dhjetor 2017 ishte shpall fituesi i këtij projekti dhe çuditërisht në këtë projekt gati milionësh nuk kishte pasur asnjë ankesë. Në kohën kur marr mandatin se kryetar ai ka gjetur një kontratë ku kanë qenë të përfunduara të gjitha procedurat tenderuese. Lidhur me këtë çështje si kryetar komune i kishte shkruar KRPP-së dhe me datën 2 shkurt 2018 kishte pranuar një letër nga KRPP-ja ku ndër të tjera thuhej: nëse e ke deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve të nënshkruar nga autoriteti duhet të vazhdohet me procedurën e prokurimit, mandej paragrafi i fundit i përgjigjes është: autoritetit kontraktues duhet ti ketë parasysh pasojat eventuale nga i cilido vendim që e merr gjithsesi mbetet në përgjegjësi e autoritet kontraktuese në rast të konsekuencave që mund të rrjedhin nga vendimi për anulim apo vendimi për nënshkrim të kontratës. Pas kësaj përgjigje të marr nga KRPP-ja si kryetar i komunës i kishte shkruar Ministrin të Kulturës dhe sekretarit permanent të kësaj ministrie ku i kishte kërkuar që të nënshkruhet deklarata e disponueshmërisë së mjeteve dhe për më tepër për këtë problematik ishte njoftuar edhe kuvendi komunës. Pastaj në muajin mars kishte marr përgjigje nga sekretari permanent në Ministrin e Kulturës, ku ndër tjera ai shkruante: ju rikonfirmoj edhe një herë që MKRS për këtë vit fiskal sipas buxhetit të aprovuar për vitin 2018 ka në dispozicion 50.000.00 €, por në procesin e rishikimit të buxhetit që do të ndodh në muajin qershor sipas kalendarit fiskal të përcaktuar në bazë të kornizës ligjore ne do të kërkojmë pjesën tjetër të buxhetit në pajtim me memorandumin dhe aneks memorandumin e nënshkruar me Komunën e Vushtrrisë, kurse bashkangjitur me këtë përgjigje kemi edhe deklaratën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 25.000.00 €. Andaj përballë të gjitha këtyre fakteve ai si kryetar i komunës bashkë me partneret e koalicionit ka qenë përball dy vendimeve të mban një premtim elektorale që është bërë më herët për mos rrënim të këtij objekti apo të anulon kontratën dhe kështu të dëmtohet financiarisht komuna në kontest gjyqësor. Në fund ai tha se do të vazhdoj të punoj dhe ta mbroj me çdo kusht interesin publik të komunës, dhe vlerësoi se historia e qendrës së kulturës është një aferë korruptive dhe sot po shprehet mllefi nga grupi kuvendar i PDK-së që ai objekt po ndërtohet dhe po i prishen planet dikujt për ndërtim të banesave kolektive.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit –tha se nuk është mirë të manipulohet me të vërteten, për faktin se PDK kur kishte marr vendim për rrënimin e pjesëshëm të këtij objekti, nuk e kishte pas për destinim ndërtimin e banesave, por kanë qenë mjetet e ndara që nga viti 2016 për

realizimin e projekti ndërtimi i qendrës së kulturë, dhe të thuash se rrënimi është bërë për ndërtim banesash kjo është një e pa vërtetë e madhe. Pastaj në kohën e qeverisjes së LDK-së është marrë vendim për rrënim të kësaj qendre pa asnjë destinim dhe kjo i sqaron më së miri qëllimet. Sa i përket akuzave të kryetarit të komunës se në atë lokacion do të ndërtohen banesa kolektive ai shprehu dyshimet e tij se a thua se ku është në dijeni kryetari për këtë apo ndoshta ka qenë pjesë e pazareve për këtë pronë. Mjetet financiare për këtë projekt kanë qenë prej të të hyrave vetanake dhe ka pasur mundësi të barten në vitin e ardhshëm, ndërsa nëse veç qytetaret kanë qenë kundër rrënimi të këtij objekti, atëherë asgjë nuk kishte me qenë nëse komuna do të humbte 100.000.00 € fitim të humbur në një kontest gjyqësorë. Grupi kuvendar i PDK-së ka qenë prej fillimit dhe mbetet prapë vendimit për rrënimin e atij objekti në të kundërtën nuk do të merrte një vendim të tillë, por në këtë rast është e udhës që të mbahet fjala publike dhe kryetari i komunës është mirë që ti publikoj ato fotografi sepse nuk janë të vërteta sepse ata do ti publikojnë dhe e vërteta do të del në shesh. Ka dëgjuar nga qytetaret se kryetari është ka shikohen në pasqyrë shpesh dhe ajo po e mashtron por ai ju betua se ajo pasqyrë shumë shpejt do ti ja qetë në tavolinë të vërteten

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit-tha se si banore e rajonit të Artakollit, i janë adresuar disa probleme dhe kërkesa të cilat bien ndesh me kompetencat komunale. Ajo se pari shtroi problemin e rrugës Bukosh – Zhilivodë, ku siç tha ajo janë vërejtur probleme se punët nuk janë duke u kryer ashtu si duhet me ç’rast në urën e fshatit Vërrnicë asgjë nuk ka ndryshuar përpos shtresës së zhavorrit e cila nuk do të rregulloj problemin e kamotshëm të kësaj ure, për faktin se në atë vend në rastet e të reshurave të mëdha kemi grumbullim të ujit me ç’rast kjo sipërfaqe vërshohet dhe rrjedhimisht rruga bëhet e pa kalueshme. Në këtë rast në vend se të vendosen gypa nga vija e drejt e lumit, aty janë bërë devijime ku është vendosur vetëm një gyp i cili nuk do të jetë funksional gjatë të reshurave të mëdha. Lidhur me këtë problematikë ajo kërkoi nga qeveria komunale që të marr masa që siç tha ajo të mënjanohet ky problem, duke bashkëpunuar me Ministrin e Infrastrukturës. Çështja tjetër që ajo ngriti është ajo e intervenimit nga ana e Drejtorisë së Arsimit në shkollën fillore “Martirët” në fshatin Reznik për përmirësimin e kushteve higjieno sanitare për shkak se në këtë shkollë është duke kundërmuar një erë e rënd ku ka indikacione se mund të përhapet ndonjë sëmundje dhe ku dita ditës është duke u rrezikuar zhvillimi normal i procesit mësimor. Tutje lidhur me këtë problem ajo njoftoi kuvendin se për këtë problematiken drejtori i shkollës në fjalë ka bërë disa herë kërkesë për sanimin e këtij problemi por një kërkesë e tillë ishte refuzuar nga Drejtoria e Arsimit. Andaj në këtë kontekst kërkojë nga drejtoria gjegjëse që gjatë muajit të pushimit ky problem të zgjidhet, në të kundërtën kjo shkollë do ta bojkotoj procesin mësimor. Ndërsa shqetësimi tjetër i banorëve të Artakollit të cilin ajo e adresojë është ai i ndezjes së gomave ku në këtë rast lirohet një tym i cili është jashtëzakonisht i dëmshëm për shëndetin e njeriut dhe ndotjen e ambientit, lidhur me këtë ajo kërkoi nga qeveria komunale që të intervenohet dhe të parandalohet një dukuri e tillë.

Lutfi Bilalli, anëtar i kuvendit –tha se gjatë mbledhjes do të abstenojnë nga diskutimet dhe nga pjesëmarrja në votim, kjo mund të ndodh për një afat të pa limituar.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit –duke ju referuar diskutimit të kryetarit të komunës lidhur me transparencën, pyeti se futet në rrafshin e transparencës edhe punësimi i militantëve partiak, duke filluar nga punësimi i vjehrrit të tij një nepotizëm puro. Ndërsa sa i përket akuzave të kryetarit të komunës për ndërtimin e banesave kolektive në lokacionet e qendrës së kulturës, vlerësoi se kryetari nuk e di sa do t’ia arrit të bëhet ndërtues brenda mandatit pasi që ka mundësi reale që gjatë vitit 2019 të këtë zgjedhje. Pastaj kryetari i komunës flet për shoqëri civile por ne e dimë dhe kemi fakte se ajo shoqëri e ashtuquajtur civile është e shitur dhe ajo haptas ka dal në anën e kryetarit aktual ne zgjedhjet e fundit duke shkelur ligjin e Republikës së Kosovës. Është qesharake mos mbajtja e premtimit elektoral për mos dëmtim financiar të komunës, tani duhet parë se kush po na flet për mos dëmtim financiare ku shpenzimet e udhëtimit për kryetarin e komunës për katër vit shkojnë deri 120.000.00 €, qeveri e re apo qeveri e luksit pesë vetura rena car me 500 € në muaj dhe në fund ato vetura nuk mbesin të

komunës, krejt kjo sepse kryetari i komunës dëshiron të duket luksoz, por i ka lënë klubet e sportit pa asnjë cent dhe kërkon bileta bashkë me stafin e tij dhe nuk e paguna as bilën e tij për ta shikuar një ndeshje. Andaj pyeti kryetarin e komunës se ma mire kishte me qenë që gjithë ato shpenzime të udhëtimit dhe të veturave ti orienton në investime kapitale.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës –tha se është shumë e dhimbshme për qytetarin e Vushtrrisë që një anëtar i kuvendin në moshë kaq të re të thotë kaq shumë të pa vërteta në foltoren e kuvendit. Pastaj ai duke ju referua shoqërisë civile me theks të veçantë parafolësit të tij ceku se anëtari i kuvendit z.Maxhuni ka qenë vet kryetar i KVRL-së dhe aty ka qenë i instaluar nga PDK-ja dhe nga ai forum është futur në listë zgjedhore të PDK-së pikërisht për hir të babait të tij dhe jo për shkak të ndonjë aftësi tjetër. Sa i përket makinave zyrtare, ritheksoi se ka qenë premtim elektoral për uljen e shpenzimeve të mirëmbajtjes së veturave, dhe kjo po ndodh ku ne jemi bërë pjesë e kontratës për marrjen e veturave me qira dhe kjo ka ndikuar në uljen e shpenzimeve të derivateve nga 12 litra për 100 km në 7 litra. Për veturat e marra me qira komuna nuk ka obligim të paguaj mirëmbajtje as regjistrim ajo që duhet komuna të paguaj janë vetëm derivatet. Në këtë kontekst vlerësoi se në kohën e qeverisjes së PDK-së janë shpenzuar 42.000.00 € për mirëmbajtje të veturave dhe janë shpenzuar 13 litra derivate për 100 km këto janë faktet që dihen botërisht. Shifrat e prezantuar nga eksponent e PDK-së janë një shpifje e ulët por kjo mbetet çështje e tyre. Tutej ai i siguroj anëtarët e kuvendit se kurrë nuk ka hyrë në stadium për të shikuar ndeshje pa e paguar biletën por edhe kjo bënë pjesë në rrafshin e propagandës me qëllim vënien e etiketave. Puna e filluar për së mbari dhe ngritja e kapaciteteve në komunë për këta gjashtë muaj po e mundon PDK-në dhe kjo është duke ja shuar shpresat PDK-së se do të marr ndonjë pushtetin. Mandej ai u shpreh se do të punojë vetëm në interes të qytetarit dhe kurrë nuk ka do ta shfrytëzoj pushtetin për tu bërë biznesmen, ashtu siç ka vepruar qeverisja e PDK-së.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit –tha se çdo veprim të mirë të kësaj qeveria do ta përshëndet ndërto edhe veprimi për heqjen e veturave të vjetra është veprim i duhur dhe është mire që kryetari e ka mbajtur premtimin. Pastaj edhe tek projekti i shtëpisë së kulturës keni bërë mire që keni vepruar në parandalimin e dëmtimit të buxhetit të komunës. Pastaj lidhur me transparencën vlerësoi se publikimi i shpenzimeve prej vetëm 13 euro në javë nuk është i vërtet dhe kjo beson se nuk i bënë mirë as vetë kryetarit të komunës.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës –tha se në kuadër të publikimit të shpenzimeve hyjnë shpenzimet e bufesë, drekat dhe darkat zyrtare ato të naftës dhe mëditje jashtë vendit. Pastaj ceku se nuk ka thënë asnjëherë se do ti ndal shpenzimet dhe kështu ta dëmtoj punën e kuvendit dhe të ekzekutivit, por do të ketë racionalizim maksimal të shpenzimeve. Në vazhdim ai ceku se tani e tutje ai vozitet vet deri në Prishtinë, dhe edhe këtë e bënë që ti zvogëloj shpenzimet dhe për këtë ai kërkoi nga të gjithë që ta respektojnë këtë shembull të transparencës dhe mos të tentojë ta mbysin këtë shembull të mirë të publikimit të shpenzimit të parasë publike.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit –njoftoi se ai nuk ka qenë kryetar i KVRL-së por ka qenë nënkryetar, dhe shtoi se kryetari aktual e përdor shoqërinë civile atëherë kur i nevojitet në fushata elektorale. Pastaj ceku se kryetari aktual akuzon se ne nuk kuptojmë, d.m.th vetëm ky kupton aq kupton sa që masën e quan reformë dhe masa nuk është reformë. Në vazhdim ai vlerësoi se familjaret e tij nuk kanë mbajtur asnjëherë funksione publike dhe votat e marra i ka marr në saje të aktivitetit të tij politikë. Pastaj ai dha vërejtje edhe lidhur me shpenzimet e varrimit që mbulohen nga komuna ku në shumicën e komunave këto shpenzime janë nga 150 € kurse në komunë tonë këto shpenzime janë 200 € për një person.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha se gjatë fushatës elektorale për kryetar të komunës vërtet ka pasur një kulturë politike dhe ne si komunë kemi qenë shembull edhe për komunat tjera. Mirëpo tani nuk mund të themi se jemi të kënaqur kur shohim se çfarë gjuhe politike përdoret në kuvend të komunës. Tutje vlerësoi se ai nuk merret me shpifje dhe nuk dëshiron ti fryj zjarrit dhe të nxit inate në kuvend dhe mes partive të përfaqësuar në kuvend, ai ceku se më me dëshirë

diskuton për sukseset se sa për dështimit. Në fund apeloj që të jemi të kujdesshëm në gjuhën e përdorur dhe ti shërbejmë të mirës së përgjithshme.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit –tha se kjo se çka dëgjova deri me tani nuk i ka hije një kryetari që të bëjë kësi lloj përgjithësime duke etiketuar në emër të PDK-së, për faktin se PDK ka një anëtarësi mjaft të madhe dhe kjo nuk është mire. Pastaj ai shtoi se nuk duhet humbur shumë kohë duke u marr me atë se kush çka ka premtuar në fushat por ti kthemi agjendës dhe të merremi me problemet reale të qytetarëve. Lidhur me shpenzimet komunale ai ceku se për këtë janë organet kompetente juridike që nëse ka shkele atëherë do të vjen deri tek përgjegjësia e secilit që ka bërë shkelje të mundeshe. Në fund apelo që ta shtyjme përpara agjendën e kuvendit dhe që mos të humbet koha dëm dhe duke u neglizhuar problemet e qytetarit.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës –tha se e tërheq fjalën e tij lidhur me akuzat në emër të PDK-së, duke shtuar se nuk duhet bërë përgjithësime të tilla sepse 13.0000.00 votuesit e PDK-së nuk kan qeverisur me Komunën e Vushtrrisë.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit–kërko nga organet kompetente komunale që tu dilet në ndihmë me mjete financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për Florjana dhe Floresa Beqirin të cilat do të marrin pjesë në një garë ndërkombëtare të diturisë.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës –tha se nuk e ka një kërkesë të tillë dhe njoftoi se disa student tjerë janë përkrahur nga Komuna e Vushtrrisë, siç është Pranvera Hyseni, edhe për rastin e thekuar më lartë u zotua se do tu dal në ndihmë. Andaj kërkoi që kërkesa në fjalë të procedohet në komunë dhe e njëjta do të aprovohet.

Në fund të diskutimeve lidhur me rendin e ditës kuvendi në mënyrë “unanime” aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 26.04.2018;
2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Qarkoren buxhetore 2019;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Vushtrrisë për vitin akademik 2017/2018;
6. Shqyrtimi i Draft-Rregullore për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridikë – OJQ dhe ndihmë momentale personave fizikë (**shqyrtimi i dytë**);
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për renditjen në <listën e emrave rezervë të rrugëve>, emrat e propozuar: “Liman Bajram Hasani”, “Haradin Liman Hasani”, “Selman Liman Hasani”, “Ali Jakupi” dhe “Enver Morina”;
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 nr. 49/17 të datës 23.02.2017.
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin të parkut industrial në fshatin Lumadh;
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndihmë financiare për shërimin e invalidit të UÇK-së, Ismail Istrefi;
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve.
12. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e analizë teknike lidhur me pika e grumbullimit të mbeturinave.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 26.04.2018;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë 31 “për” 3 vota “abstenim” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 26.04.2018.

2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Qarkoren buxhetore 2019;

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun;

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit –pasi e përgëzoi Drejtorinë e Kulturës për zhvillimin e aktiviteteve të mira, vlerësoi se kishte me qenë mire që deri në këtë kohë të ofrohet para kuvendit propozim-vendimi për subvencionim të klubeve, dhe kjo akoma nuk është bërë, ndërsa në fushat elektorale është premtuar se do të dyfishohen mjetet financiare për klubet sportive por kjo lere që nuk ka ndodhur por klubeve nuk ju janë ndarë asnjë cent. Tutje bëri te ditur se kryetari i komunës bashkë me stafin e tij kishte hyrë në stadium për ta shikuar ndeshjen pa bërë pagesën e biletës, andaj kjo është për keqardhje.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës –duke ju referuar parafolësit të tij vlerësoi se akuzat e tilla janë shpifje të ulëta me të cilat nuk dëshiron të merret dhe kjo le të mbetet në ndërgjegjen e gjithsecilit që i deklaroi ato dhe ri përsërite se kurrë nuk kishte hyrë në stadium pa paguar biletën. Pastaj shtoi se nëse flitet për konflikt interesi atëherë mund të themi se disa eksponent të PDK-së kanë qenë në konflikt të pastër interesi pasi kanë udhëhequr me komunë dhe në të njëjtën kohë kanë qenë në strukturat udhëheqëse të klubit. Gjithashtu ai vlerësoi se është ë kotë dhe e pa dintetshme që kuvendi të merret me këso lloj shpifjesh të ulëta dhe të humbet koha e vlefshme e anëtarëve të kuvendit.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë;

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha se gjendja e pyjeve në komunën tonë nuk është e mirë, dhe pyeti se sa rojtar të pyllit janë aktualisht që i kontrollojnë pyjet. Pastaj vlerësoi se komuna duhet të punësojnë roja të pyllit për kohë të pacaktuar dhe jo të kemi punësime më kontratë mbi veprën sepse kjo nuk ka treguar rezultate të duhura.

Miran Halili, Drejtor i DBPZHR-së-paraqiti sqarime lidhur me çështjen e ngritur nga anëtari i kuvendit ku njoftoi se aktualisht i kemi gjashtë roje të pyllit dhe atë tre me kontratë të përhershme ndërsa tre me kontratë mbi veprën, për të kjo është absolutisht e papranueshme për faktin se punëtorët me kontratë mbi veprën nuk e kanë angazhimin dhe përkushtimin maksimal në punë, andaj duhet bërë përpjekje që rojat e pyjeve të jenë me kontrata të përhershme.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Vushtrrisë për vitin akademik 2017/2018;

Gresa Muli, anëtare e kuvendit- pasi përshëndeti të pranishmit, tha se si anëtare e komisionit për ndarjen e bursave e sheh te nevojshme te flas tek kjo pike e rendit të ditës. Fillimisht sa i përket ndarjes se bursave për vitin akademik 2017/2018 ne si komision kemi dhënë maksimumin për përzgjedhjen e drejte te përfituesve duke e shikuar e rishikuar çdo detaj ne dokumente dhe aplikacione dhe pas 4 takimesh te komisionit kemi ardhur ne përfundim te listës se përfituesve. Puna kishte mundur te jete me e lehte sikur te kishim për baze një rregullore e cila nuk len dy kuptimsi siç është kjo aktualja. Kjo rregullore ka nevojë për ndryshime, plotësime dhe përmirësime ne drejtim te kritereve me te qarta dhe me konkrete te cilat konsideroj te rrugën qe te kenë gjithmonë për baze notën mesatare. Prandaj I bej propozim

drejtorisë përkatëse dhe kuvendit që të formoj një komision për plotësim ndryshimin e kësaj rregulloreje në mënyrë që në vitin e ardhshëm ndarja e bursave të bazohet në një rregullore të mirëfilltët. Ju faleminderit për vëmendje dhe urime studenteve përfitues për këtë vit.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës – e falënderoi komisionin për ndarjen e bursave, për siç tha për punën e tyre profesionale, të paanshme dhe të drejt, dhe vlerësoi se kjo ndihmon në ngritjen e kredibilitetit dhe besueshmërisë të studentëve tek institucionet.

6. Shqyrtimi i Draft-Rregullore për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridikë – OJQ dhe ndihmë momentale personave fizikë (shqyrtimi i dytë);

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-propozoi që në kuadër të rregullores të inkorporohen këto propozime: tek nenin 23 paragrafi 2 ku thuhet se: pagesa e qirasë nuk mund të bëhet më shumë se për pesë (vite), duhet të shtohet fjali llogaritur nga 1 janari 2019, kurse përjashtim nga ky rregull janë rastet kur pas afatit prej pesë viteve komisioni vlerëson se duhet të zgjatet qiraja me maksimum edhe për dy vite tjera. Pastaj tek neni 24 nënparagrafi 1.3 duhet të përmirësohet në 1.6 sipas renditjes logjike, në këtë nënparagraf thuhet: se qiramartja kalon pas afatit prej pesë (5) viteve nga lidhja e kontratës, këtu duhet të shtohet fjalia dhe komisioni nuk ka dhënë vlerësim për vite shtesë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridikë – OJQ dhe ndihmë momentale personave fizikë me propozimet e paraqitura më lart.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për renditjen në <listën e emrave rezervë të rrugëve>, emrat e propozuar: “Liman Bajram Hasani”, “Haradin Liman Hasani”, “Selman Liman Hasani”, “Ali Jakupi” dhe “Enver Morina”;

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha se për emërtimin e rrugëve ka qenë i ngarkuar një komision por si duket ai komision nuk e ka kryer punën se duhet, pasi gjendja ka mbetur e njëjte si në të kaluarën. Tutje ai shprehu ankesat e tij për një rrugë e quajtur “Shaban Tahiri”, për këtë ai ka bërë ankesë dhe kjo ankesë asnjëherë nuk është realizuar.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 25 vota “për” të tjerat “abstenime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim renditen në Listën e emrave rezervë, emrat e rrugëve të propozuar si në vijim: “Enver Morina” nga fshati Akrahticë, „Liman Bajram Hasani”, „Haradin Liman Hasani” dhe „Selman Liman Hasani” (të tre nga fshati Stroc) dhe “Ali Jakupi” nga Vushtrria, në mënyrë që të përdoren për emërtime apo riemërtime të reja të rrugëve në të ardhmen.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 nr. 49/17 të datës 23.02.2017.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – propozoi Mehdi Bejtullahun për anëtar të komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 29 vota “për” të tjerat “abstenime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë lidhur me themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane me numër të protokollit 01.Nr.49/17 i datës 23.02.2017, ku në vend të ish-anëtarit të kuvendit z. Isa Hajrizi emërohet z. Mehdi Bejtullahu anëtar i kuvendit.

2.Mandati i anëtarit të këtij komisioni është i njëjtë me anëtarët tjerë dhe zgjat deri në finalizimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, si dhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, të cilat janë në procedurë për t'u zgjedhur.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i sipërcekur. Kurse, monitorimin e bën Drejtoria për Administratë.

4.Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin të parkut industrial në fshatin Lumadh;

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës –tha se ndihet shumë mirë që brenda këtyre gjashtë muajve të qeverisjes së re po jetësohet premtimi i tij kryesor gjatë kampanjës elektorale për themelimin e parkut industriale, ku shumë shpejt pritet zhvillimi i projekti sa i përket investimeve në infrastrukturë dhe kështu do të mundësohet vendosja e bizneseve në këtë parake, për këtë falënderoj administratën komunale dhe partneret e koalicionit për punën e madhe që kanë bërë në realizmin e këtij projekti.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim themelohet Parku Industrial në fshatin Lumadh të Komunës së Vushtrrisë në parcelat e evidentuara në certifikatat e pronësisë P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3, tokë jo pjellore, në sipërfaqe prej 14.86.00 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2.Obligohet Kryetari i Komunës përkatësisht Qeveria Komunale që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të siguruar respektimin e të gjitha procedurave të parapara ligjore deri në finalizimin të këtij projekti.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe Drejtoria e Prokurimit.

4.Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndihmë financiare për shërimin e invalidit të UÇK-së, Ismail Istrefi;

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit –tha se kërkesa e palës ka qenë për ofrimin e ndihmës prej 3.000 €, por edhe rekomandimi i KPF-së ka qenë që të përkrahet kjo shumë, andaj kërkoi që kjo shumë mos të ndryshohet por të jetë ashtu siç ka kërkuar pala në vlerë prej 3.000 €.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha se parashtruesi i kërkesës ka qenë pjesëtarë i UÇK-së dhe në luftë ka qenë i plagosur, tanin ai e ka gjendjen jo të mirë ekonomike dhe kërkoi që kjo kërkesë të mbështete.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së-paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se në mbledhjen e KPF-së ishte vendosur që drejtoria të përcaktojë shumën e ndihmës konform mundësive buxhetore. Andaj njoftoi se ka disa raste që janë ndihmuar dhe fondi për shërim është i kufizuar dhe kështu që shuma prej 2000 € është propozuar nga komisioni i drejtorisë brenda kapaciteteve të lejuara buxhetore.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit –tha se propozimi në KPF ka qenë që ky veteranë të ndihmohet me 3.000 €, dhe kështu është dashur edhe drejtoria të sjell propozimin e tani kuvendi do ta vlerësoi se a ka mjete apo jo dhe të vendos për uljen e kësaj vlere.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 18 vota “për” 2 “kundër” të tjerat “abstenime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës-fondi për subvencione dhe transfere, pozicioni “Ndihmë për shërim” në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale për Ismajl Istrefin, me banim në rr.“Mursel Istrefi” në Vushtrri, në shumën prej 2000 € (dy mijë euro).

2.Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi ndahet me qëllim të shërimit të tij.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit –propozoi Ilmi/Hysni/Saraçin që ti ndahet një mirënjohje, për kontributin e tij në tri lufta në trojet shqiptare ku në luftën e Kosovës është i plagosur. Tutje vlerësoi se është udhës që këtë ditë të shënuar në çlirimin e Vushtrrisë ja vlen që ti jepet mirënjohje këtij veteran.

Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendi-propozoi Elvira Mazhiqin për mirënjohje, për kontributin e saj ku ka marrë disa çmime në fushën e këndimit dhe ka përfaqësuar qytetin në shumë gara e koncerte muzikore dhe i ka sjell disa trofe qytetit tonë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit –propozoi që të gjitha propozimet për dekorata të votohen në pako, dhe që këto dekorata mos të ndahen në baza politike por në ditën e çlirimet të ketë një festë të përbashkët, kurse tek titulli “nderi i qytetit” propozoi që të hiqet shpërblimi financiar dhe që të tre kandidatëve tu ndahet ky titull.

Fatmire Cecelia, drejtoreshë DKRS-së-paraqiti sqarime për anëtarët e kuvendit, duke njoftuar se shoqatat e dala nga lufta janë konsultuar gjatë hartimit të propozimit për ndarjen e dekoratave, dhe ato kanë deklaruar se për këtë vit nuk kanë pasur ndonjë emër që ta propozojnë për dekoratë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-pasi falënderoi ata të cilët e propozuan për titullin “nderi i qytetit” deklaroi se tërhiqet nga kandidatura e tij për këtë titull.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës –falënderoi anëtarin e kuvendit z.Januzi për gjithë kontributin e tij si në të kaluarën ashtu edhe për ndihmën e tij të pa kursyer në zgjedhjet e fundit për ndryshimin e madh që ka ndodhur në Komunën e Vushtrrisë. Andaj vlerësoi se ky njeri është nderi i komunës sonë, edhe pse ai formalisht u tërhoq nga një titull i tillë. Një titull të tillë sigurisht se do ti ndahet në të ardhmen të lart cekurit pasi një titull të tillë ai e meriton.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit- tha se në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës na janë dhënë tre emra të qytetarëve të Vushtrrisë për të zgjedhur mes tyre njërin për ta shpallur Nderi i Qytetit nga të cilët baci Ali u tërhoq pak më parë. Ne kemi pranuar gjithashtu një peticion me nënshkrimin e qindra qytetarëve të cilët e shohin të nevojshme që ky titull ti jepet z. Naser Imeri. Më gjithë respektin që kam për humanizmin që e bënë z. Naser Imeri dhe veçanërisht për iniciativën për rastin e bashkëqytetarit tonë Qendrim Aliut, unë mendoj se duhet të shikojmë edhe disa veçori tjera që nuk mund të karakterizojnë z. Imeri si Nder i Qytetit. Humanizmin e kemi obligim moral dhe për të jemi të obliguar edhe me fe, varësisht nga pasuria që e posedojmë mirëpo si mund të jetë qytetar nderi një njeri falë të cilit ka qytetar të Vushtrrisë që nuk mund të hapin as dritaret e shtëpisë qoftë për pak kohë të shkurtë. Si banore e fshatit Sfaraqak ka vite që përballemi me probleme për shkak të kompanisë pronar i së cilës është z. Naser Imeri. Fabrika për përpunimin e betonit e cila është në fshatin Sfaraqak përkatësisht skaj rrugës magjistrale paraqet sa rrezik aq edhe shqetësim për banorët e këtij fshati dhe veçanërisht për banorët që janë shumë afër kësaj fabrike, betoni që lirohet çdo ditë nga kjo fabrikë në pusëtë veçse ka filluar të bllokoj kanalizimin që para disa vitesh është bërë me participim të banorëve të këtij fshati. Fatkeqësisht z. Imeri ka ndërtuar këtë fabrikë në situatë të çuditshme në pronë publike, ka shkelur ligjin sipas të cilit parashihet që vendosja e një fabrike të tillë duhet të bëhet me miratimin e banoreve përreth me perimetër prej 250m me ç’rast në këtë largësi nga kjo fabrikë është shkolla filllore në të cilën vijojnë mësimin nxënësit e fshatrave Sfaraqak dhe Nadakovc, është objekti që është paraparë si shkollë për fëmijë me nevoja të veçanta e cila nuk është akoma në funksion, janë shtëpitë e banorëve të këtij fshati.

Në fillimin e ndërtimit të kësaj fabrike këto dy fshatra kanë nënshkruar një peticion për ndalimin e saj mirëpo fatkeqësisht ky peticion nuk është marr parasysh siç po merret peticioni që z. Imeri ta emërojë si Nder i Qytetit. Më vjen keq që baci Ali u tërhoq nga kjo garë e cila mendoj që nuk i shkon aspak për shtati personalitetit dhe veprave të tij shumëvjeçare të cilat na bëjnë të krenohemi që e kemi bashkëvendës megjithatë njerëzit që e njohim e dinë se baci Ali sa ka kontribut ka aq edhe modesti dhe për veprat dhe kontributin e tij asnjëherë nuk e pa të nevojshme që pas të ketë një fotograf apo gazetar.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit –tha se z.Imeri ka ndihmuar shumë sa dikush as që mundet ta merr me mend, dhe shtoi se e meriton ti jepet titulli “Nderi i qytetit”. Pastaj vlerësoi se kur bëhet fjalë për peticionin për të cilin parafolësja i referohet, ai ceku se tani LVV-ja nga e cila vjen znj. Gresa Muli është duke qeverisur me Komunën e Vushtrrisë dhe për këtë çështje le të merr masat adekuate. Në fund tha se nuk është mirë që në një moment kaq të veçantë sikur sot gjërave tu japim kahe politike, dhe ceku se propozimi i tij ishte që votimi të bëhet në pako për tre të propozuarit.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-paraqiti para kuvendit një rezymë të përgjithshme lidhur me të nomnuarit për dhënie të dekoratave, dhe për së cilin paraqiti arsyetim.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –propozoi Faton Shabanin për anëtar të komisionit përcjelljen dhe mbarëvajtjen e votimit për ndarjen e dekoratave.

Sadije Klinaku, anëtare e kuvendit-propozoi Nezir Klinakun për anëtar të komisionit të lart cekur.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit-propozoi Agim Bregajn për anëtar të komisionit të lart cekur.

Agron Perçuku, anëtar i kuvendit-propozoi Mejreme Ismajlin për anëtare të komisionit.

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit-propozoi Fatmire Saraçin për anëtare të komisionit në fjalë.

Pas dhënies se propozimeve kuvendi me 24 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi themelimin e komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit për ndarjen e dekoratave në këtë përbërje:

Fatmire Saraçi (PDK);

Agim Bregaj (LDK);

Faton Shabani (LVV);

Nezir Klinaku (LB);

Mejreme Ismajli (E Pavarur).

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës –sqaroi se nuk ka kërkesë zyrtare për ofrimin e ndihmës financiare, për nxënëset tona që do të marrin pjesë në një garë diturie në SHBA, andaj kërkoi nga anëtarët e PDK-së që mos ta politizojnë këtë çështje në rrjetet sociale. Pastaj njoftoi se në këtë garë po marrin pjesë disa shtetet ndërsa nga Kosova kemi dhjetë aplikantë që kanë përfituara. Ai i përgëzoi studentet tona dhe u zotua se atyre do tu dal në ndihmë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit –konstatoi se fletëvotimet për dekorata janë te gatshme dhe në gjendje të rregullt, andaj vlerësoi se mund të fillohet me procesin e votimit. Ai paraqiti sqarime lidhur me mënyrën e votimit, ku ceku se për mirënjohje mund një anëtar i kuvendit mund ti votoj deri ne dhjetë kandidat kurse për titullin “nderi i qytetit” vetëm njërin nga kandidatët.

Pas përfundimit të votimit të fshehtë kuvendi me 16 vota ”për” vendosi që titulli “Nderi i qytetit” ti ndahet Emin Selacit.

1. Me këtë vendim, Emin Selacit nga Komuna e Vushtrrisë i ndahet çmimi “Nderi i Qytetit”, për kontributin e dhënë si: veprimtar, humanist, si njëri ndër nismëtarët e parë për themelimin e Shoqatës Humanitare Bamirëse “Nëna Terezë” në Vushtrri, për ndihmën e ofruar për familjet e minatorëve, arsimitarëve, punëtorëve në përgjithësi dhe skamnorëve.

2. Dorëzimi i këtij titulli do të bëhet nga Kryetari i Komunës me datën 17 qershor-Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Sa i përket ndarjes se mirënjohjeve kuvendi i komunës pas përfundimit të votimit të fshehtë vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim, për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17 qershor 2018 nderohen me mirënjohje:

1.1 Mustafë Venahari (post mortum)- veprimtar i çështjes kombëtare;

1.2 Bahtir Haradinaj – ish i burgosur politik, veprimtar i çështjes kombëtare;

1.3 Jakup Krasniqi-veteran i arsimit, ish drejtor komunal i arsimit;

1.4 Jakup Muzaqi-për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së dhe ofrimin e ndihmës për popullatën civile në ZOSH, gjegjësisht në fshatin Kurillovë;

1.5 Halim Selaci- për kontributin e tij në fushën e kulturës dhe arsimit;

1.6 Muhamed Alidema- për kontributin në fushën e sigurisë dhe bashkëpunimin ndërinstucional me komunën. Zyrtarë policorë nga gjenerata e parë e Policisë së Kosovës, aktualisht komandant i Stacionit Policorë në Vushtri;

1.7 Familja e Hajrullah Shalës-për kontributin në fushën e arsimit, ndërtimin e shkollës së fshatit Akrashticë;

1.8 Sedat Islami, për kontributin e tij në fushën e edukimit fetar;

1.9 Pranvera Hyseni-studente e dalluar;

1.10 Edi Mehana- për arritjen në fushën e artit.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

12.Të ndryshme.

a).Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e analizë teknike lidhur me pika e grumbullimit te mbeturinave.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim jepet në diskutim publik Projekt-Piloti për Analizën Teknike të Pikave të Grumbullimit të Mbeturinave të Komunës së Vushtrrisë.

2. Diskutimi publik fillon nga data 04 qershor 2018 dhe zgjat deri më 22 qershor 2018.

3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që si propozues i projekt-analizës në fjalë të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të projekt-analizës në fjalë në mbledhjen e kuvendit në muajin qershor 2018.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

b). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-ripërsërit problemi që ka fshati Pasomë, për shkak të eksploatimit të një guri (shkëmbi), me ç' rast nga ai gur është përdorur si materiale për shtrimin e rrugëve, por esenca është se nga shfrytëzimi i atij guri shkaktohet pluhur i madh dhe këto pasoja i bartin qytetaret e asaj ane. Pastaj cekur se në fshatin Pasomë është një rrugë në gjatësi prej 300 m e cila është e pa asfaltuar dhe kjo rrugë është planifikuar të ndërtohet por ky projekt akoma nuk është përfunduar, andaj për këto çështje kërkoi që qeveria ti ketë prioritet. Gjithashtu në prioritet duhet të futet edhe rruga Sllatinë-Tarllabuq. Mandej ai adresoi një kërkesë të banorëve të fshatit Galic të cilët kërkojnë që në kullën e "Azem Galicës" të vendoset shtroja dhe mbuloja (sfungjerë).

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –adresoi shqetësimin e tij si mësimdhënës por edhe shqetësimin e banorëve të fshatit Stanoc i Epërm, në lidhje me caktimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit në shkollën fillore "Migjeni" në këtë fshat. Lidhur me këtë problematik vlerësoi se Drejtoria e Arsimit duhet të jetë e kujdesshëm kur bënë zëvendësimin e këtyre drejtorëve në rastet e skadimit të kontratës. Pastaj shtoi se në shkollën e lart cekur ka mësimdhënës të cilët e kanë dijen dhe përvojën për të udhëhequr me atë shkollë. Andaj duke i marr për bazë rrethanat në atë shkollë ai dyshon se personi i caktuar si ushtrues detyre i drejtorit do mund të arrij objektivat e asaj shkolle. Konform kësaj situatë ai kërkoi nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit gjegjësisht nga kryetari i komunës që me rastin e emërimeve të mos bëhen emërime politike, por të emërohen njerëz përgjegjës të cilët e duan arsimin dhe të cilët jetojnë në Komunën e Vushtrrisë, pasi që ushtruesja e detyrës së drejtorit nuk është nga Komuna e Vushtrrisë, dhe në nga Vushtrria e kemi shumë të vështirë që të gjejmë një vend pune në shkollat e komunave tjera. Në fund ai kërkoi mirëkuptim nga të gjithë dhe cekur se në të ardhmen nuk duhet të ndodhin raste të tilla.

Mbledhja përfundoi në ora 13:55.

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit